




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KA/Nr. 2911/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, të datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dermaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit Biznesi, nr.prot.1112/20H, datë 29.07.2020 kundër Vendimit të KSHC Nr. 979/20D të datës 21.07.2020 për mos akreditim institucional, e pranuar më 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 11.11.2020, me shumicë votash, mori:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit Biznesi Nr. 1112/20H e datës 29.07.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së nr. 979/20D i datë 21.07.2020.

ARSYETIM

Kolegji Biznesi më datë 29.07.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij të datës 21.07.2020, nr. 979/20D, me të cilin nuk është riakredituar në nivel institucional. Pala me ankesën e datës 29.07.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë pa të drejtë ka refuzuar akreditimin në nivel institucional duke u bazuar në vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike.

Më tutje, pala ka sqaruar se pas aprovimit të aplikacionit nga KSHC, me datë 03.06.2020, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka organizuar vlerësimin institucional (në mënyrën online) të Kolegjit Biznesi.

Pas pranimit të draft raportit nga ana e AKA-së, Kolegji Biznesi ka dhënë te gjitha sqarimet e kërkuara dhe të nevojshme me qëllim të informimit të drejtë të ekspertëve vlerësues, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore.

Me datën 21.07.2020 Kolegji Biznesi ka pranuar nga AKA raportin final të ekspertëve dhe vendimin e KSHC-së (nr.979/20D, datë 21.07.2020) me të cilin vendim Kolegji Biznesi nuk riakreditohet në nivelin institucional.

Pala pretendon se ekipi i ekspertëve i përbërë nga Milan Pol, Janez Vogrinc dhe Keti Tsotniashvili kanë bërë vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike rreth përmbushjes së standardeve:

- Misioni publik dhe objektivat institucionale
- Mësimdhënia dhe të nxëniet
- Burimet dhe hapësirat
- Menaxhimi I cilësisë
- Hulumtimi
- Stafit, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional

Provat e administruara:

- Vendimi i KSHC-së Nr. 979/20D i datë 21.07.2020;
- Raporti final i ekipit të ekspertëve;
- Përgjigjet e Kolegjit Biznesi dërguar në AKA rreth draft raportit të ekipit të ekspertëve;
- Raporti i vetëvlerësimit;
- Raporti i KSHC-së për ri-shqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën nr. 1112/20H të datës 29.07.2020, e Kolegjit Biznesi më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar nga AKA për vlerësimin e Kolegji Biznesi nga gjithsej njëmbëdhjetë (11) kapituj të standardeve të përcaktuar në **Manualin për akreditim** (Korrik 2018) plotëson substancialisht 1 standard, pjesërisht 6 standarde dhe nuk plotëson 4

prej këtyre standardeve. Po ashtu, ekipi i ekspertëve në fund të raportit ka rekomanduar që të mos akreditohet në nivel institucional Kolegji Biznesi.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit Biznesi është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos akreditimin institucional.

Komisioni i Ankesave e ka analizuar raportin e ekspertëve ku ekspertet ndërkombëtarë nuk kanë rekomanduar akreditimin në nivel institucional të Kolegjit Biznesi sepse i njëjti nga gjithsej 11 kapituj të standardeve të përcaktuar në Manualin për Akreditim plotëson substancialisht 1 standard, pjesërisht 6 standarde dhe nuk plotëson 4 prej tyre.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, i cili përcakton se: *"Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm, KSHC merr vendimin për akreditim ose mos akreditim."*

Nga kjo, mund të vërehet se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për përmbushjen e standardeve sipas Manualit për Akreditim (Korrik 2018) e i cili përcakton se: *"Për të marrë një vendim pozitiv për programin dhe ri-akreditimin institucional, çdo ofrues i arsimit duhet të demonstrojë të paktën një nivel të konsiderueshëm pajtueshmërie në gjykimin e përgjithshëm. Prandaj, dështimi në përmbushjen e të paktën një niveli të përgjithshëm të pajtueshmërisë përfshinë vonimin, tërheqjen, pezullimin ose mohimin e akreditimit".*

Andaj, sipas nenit 18, paragrafin 2 të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Komisioni i Ankesave vlerëson se mbi këtë bazë ligjore ka arsyeshmëri të plotë Vendimi nr. 573/20D, datë 22.06.2020 i KSHC-së.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji Biznesi e ka realizuar këtë të drejtë, por nuk ka parashtruar ndonjë provë apo argument shtesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2911/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.